



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 5871 Prot.

Durrës, më 08.04.2019

VENDIM

Nr. 20, datë 08.04 2019

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, sipas kërkesave për personelin akademik të ftuar nga fakultetet, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 08.04.2019,

VENDOSI:

1. Për miratimin e personelit akademik të ftuar, të vihen në dispozicion të Senatit Akademik dokumentacioni si më poshtë:
 - Ftesa nga përgjegjësi i departamentit për personelin akademik të ftuar.
 - Relacion argumentues mbi kualifikimet e personelit akademik të ftuar në nevojën e njësisë bazë për veprimtaritë e mësimdhënies ose kërkimore-shkencore.
 - Titulli dhe grada shkencore (Prof.As.Dr, dhe Prof.Dr.)
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Drejtuesit e njësisë bazë
 - Drejtuesit e njësisive kryesore
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI